



Komuna e Shtimes
Municipality of Shtime

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E SHTIMES

Nr. Prot. & Prot. 02/50

Nr. Fajevë/Strana 3

Data/Chet 24/02/2026

SHTIME/SHTIME

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
ISLAMIC COMMUNITY OF KOSOVO
KËSHILLI I BASHKËSISË ISLAME
COUNCIL OF ISLAMIC COMMUNITY

Data/Prot. 24.02.2026 Bashk. No/26
Islame
e Kosovës

Bashkësia Islame e Kosovës
Këshilli i Bashkësisë Islame

Datë: 24.02.2026

Nr.prot: 02/162

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

Komuna e Shtimes e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. **Qemajl Aliu**, në tekstin në vijim:
(Komuna)

dhe

Këshilli i Bashkësisë Islame, përfaqësuar nga Kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame në Shtime,
z. Skender Baftiu

Në kuadër të autorizimeve përkatëse, sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes, me Nr. NPI-01/26 të datës 27.01.2025, palët lidhin këtë:

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

PËR SUBVENCIONIMIN E SHPENZIMEVE PËR SHËRBIMET E VARRIMIT

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj Marrëveshjeje është që Komuna e Shtimes të subvencionojë kryerjen e shërbimeve të varrimit për qytetarët që varrosen në territorin e Komunës së Shtimes, në shumë prej **300€ (treqind euro)** për secilin rast të vdekjes, ndërmjet Këshillit të Bashkësisë Islame në Shtime, i cili kryen shërbimet e varrimit sipas rregullave dhe traditave përkatëse, konform Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. NPI-01/62 të datës 27.01.2025.

Neni 2

Lënda

Shërbimet e varrimit përfshijnë: lajmërimet, pastrimin e kufomës, qefinin, mbulesën e kufomës, dërrasat, piramidën, hapjen e varrit dhe kryerjen e riteve fetare (banjo, kujdestaria, transporti i kufomës brenda territorit të komunës, mjete higjienike). Subvencionimi i shërbimeve të varrimit,

sipas kësaj Marrëveshje në asnjë mënyrë nuk ndërlihet me pagesën e anëtarësisë ndaj Bashkësisë Islame. Anëtarësia në raportin Xhemat KBI, mbetet si në të kaluarën.

Neni 3

Obligimet e Bashkësisë Islame

1. Këshilli i Bashkësisë Islame, në baza mujore, më së largu me datën 5 të muajit vijues, parashtron kërkesën për kompensim të shërbimeve përkatëse, të cilën kërkesë ia drejton Zyrës së Kryetarit të Komunës.
2. Kërkesës së cekur në paragrafin e parë duhet t'i bashkëngjitet:
 - 2.1. Regjistri i personave të vdekur për muajin përkatës;
 - 2.2. Certifikata e numrit fiskal;
 - 2.3. Konfirmimi i llogarisë bankare;
 - 2.4. Aktivizimi i arkatarit;
 - 2.5. Kopja e letërnjoftimit të arkatarit.
3. Marrëveshja është valide nga muaji shkurt 2026 deri në ndryshimin e vendimit NPI-01/26 të datës 27.01.2025. Komuna ka të drejtë që të kërkojë edhe dokumente të tjera, që i konsideron si të nevojshme për shqyrtimin dhe përfundimin e kërkesës së cekur në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 4

Obligimet e Komunës së Shtimes

1. Komuna e Shtimes duke u bazuar në kërkesën dhe dokumentacionin tjetër të bashkëngjitur përmes drejtorisë së Financave bënë ekzekutimin e obligimeve brenda afatit ligjor të përcatuara nga ligji i MFPT si dhe rregullat tjera të Thesarit.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen në mes veti që në rast të paraqitjes së ndonjë mosmarrëveshje gjatë zbatimit të këtij Memorandumi, çështjet të zgjidhen me dialog dhe mirëkuptim, e në rast se përsëri nuk ka dakordim, mosmarrëveshjet do të zgjidhen në Gjykatën kompetente.

Neni 6

Numri i kopjeve

Marrëveshja e Mirëkuptimit nënshkruhet në tre kopje origjinale dhe nga një kopje mbetet për secilën palë nënshkruese, kurse një kopje për arkivë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese janë pajtuar që kjo Marrëveshje e mirëkuptimit të fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

z. Qemajl Aliu
Kryetar i Komunës së Shtimes



z. Skender Baftiu
Kryetar Bashkësisë Islame në Shtime

